



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01.nëntor 2011
Nr. ref.:148/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI52/11

Parashtrues

X

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së një Aktgjykimi të Gjykatës Supreme të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është banor i Republikës së Kosovës që ka kërkuar mbrojtje të identitetit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është një Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin është refuzuar ankesa ndaj një Vendimi të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS) - Departamenti i Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: DMS).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me atë Aktgjykim të Gjykatës Supreme të Kosovës i është cenuar e drejta për mbrojtje sociale e parashikuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 15 prill 2011, parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
6. Më 10 maj 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.
7. Më 23 shtator 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Dr. Iliriana Islami i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës dhe për miratimin e kërkesës për mbrojtje të identitetit të parashtruesit të kërkesës.

Mbrojtja e identitetit të parashtruesit të kërkesës

8. Gjykata vërejti arsyet e kërkesës së parashtruesit për mbrojtje të identitetit të cilat, mu për shkak të natyrës së tyre, nuk të do të zbulohen. Gjykata e konsideroi kërkesën të bazuar dhe rrjedhimisht e miratoi kërkesën për mbrojtje të identitetit. Për këtë arsye, elemente të ndryshme të fakteve që do të mund të çonin deri te zbulimi i identitetit të parashtruesit të kërkesës do të hiqen nga Vendimi.

Përmbledhje e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës pohon se vuan nga një sëmundje e pashërueshme dhe se atë sëmundje e ka trashëguar edhe fëmija i tij/saj. Pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur mundësi të sigurojë barnat, ai/ajo ka paraqitur kërkesë për njohjen e të drejtës për mbështetje financiare në Qendrën për Punë Sociale në Z për mbështetje të familjeve me fëmijë me nevoja të veçanta.
10. Qendra për Punë Sociale në Z vendosi ta refuzojë si të pabazë kërkesën për njohjen e të drejtës për mbështetje financiare të familjes që kujdeset për fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme për fëmijën Y në bazë të mendimit të Komisionit Mjekësor të shkallës së parë.
11. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij Vendimi në Këshillin e Ankesave të MPMS-DMS në Prishtinë, si organ i shkallës së dytë.
12. Pas shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në Prishtinë, si organ i shkallës së dytë, vendosi të refuzojë ankesën dhe vërtetoi Vendimin e Qendrës për Punë Sociale në Z. Ky Vendim është

marrë në bazë të mendimit të Komisionit Mjekësor të shkallës së dytë, në të cilin është theksuar se nuk ekziston aftësia e kufizuar e përhershme.

13. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Vendimit të Këshillit të Ankesave në Prishtinë,
14. Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi ankesën si të pabazuar, duke theksuar se nga shkresat e lëndës shihej që mendimet mjekësore të Komisionit Mjekësor të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë konkludonin se fëmijës Y nuk mund t'i njihet e drejta për mbështetje materiale sepse nuk ekziston aftësia e kufizuar e përhershme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës i është cenuar e drejta për mbrojtje sociale. Parashtruesi i kërkesës pohon që është shkelur neni 51, paragrafi 2, i Kushtetutës i cili parashikon të drejtën për mbrojtjen shëndetësore dhe sociale.
16. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se ka pasur shkelje të nenit 102, paragrafi 3, të Kushtetutës, i cili obligon gjykatat që të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit, duke theksuar se Gjykata Supreme nuk kishte zbatuar drejt nenet 6, 10, 11 dhe 13 të Ligjit për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme.
17. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 22 të Kushtetutës i cili parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, përkatësisht nenit 13 të Kartës Sociale Evropiane të vitit 1996.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pohon se neni 51, paragrafi 2, (E drejta për Mbrojtje Shëndetësore dhe Sociale), neni 102, paragrafi 3, (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor), dhe neni 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) të Kushtetutës së Kosovës, paraqesin bazë për kërkesën e parashtruar.
19. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parashikon:
“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”
20. Në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e Apelit, kur shqyrtohen vendimet e marra nga ana e gjykatave më të ulëta. Roli i gjykatave më të ulëta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të procedurës dhe të drejtës materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruis kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
21. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se në çfarë mënyre nenet 22, 51 dhe 102 mbështesin kërkesën e tij, siç është përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
22. Parashtruesi i kërkesës pohon se i janë cenuar të drejtat me konstatimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave më të ulëta, pa saktësuar qartazi se në çfarë mënyre me ato vendime i janë cenuar të drejtat kushtetuese.

23. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e vet dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se ishte i gabuar, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe në Gjykatën Supreme. Pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse ishin në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
24. Si përfundim, në këtë kërkesë nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të mbështesë me prova pretendimin se me vendimin e kontestuar i janë cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese.
25. Prandaj, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili parashikon që: “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56, paragrafin 2, dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 shtator 2011, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović




Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

